



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr 1586 prot.

Berat , më 21 / 03 / 2023

V E N D I M

Nr. 153 Datë. 21 / 03 / 2023

P Ë R

**“PËRDORIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE DHE RREGULLAT
PËR AFISHIMIN E TYRE”**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 7, pika 2, neni 9, pika 1.1, gërma “b”, neni 64, gërma “a”, ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative, Udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

V E N D O S A:

1. Materialet propagandistike zgjedhore lejohet të afishohen deri në një distancë prej 5 (pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjekteve zgjedhore përkatëse.
2. Caktimin e vendeve publike në territorin e Bashkisë Berat për afishimin e materialeve propagandistike prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore do të jetë si më poshtë:
 - Rruga “Antipatrea”, pranë “ish-Kinoklubit”
 - Rruga “Antipatrea”, përballë Shkollës së Mesme “Kristaq Capo”
 - Rruga “Antipatrea”, pranë “Varrezave të Dëshmorëve”
 - Rruga “Antipatrea”, përbri Pallatit të Kulturës “Margarita Tutulani”
 - Rruga “Antipatrea”, përballë Pallatit të Kulturës “Margarita Tutulani”
 - Rruga “Antipatrea”, përballë Raiffeisen Bank, Këshillit të Qarkut Berat.
3. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë dhe rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe shtyllat e ndriçimit.
4. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Policia Bashkiake.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë .

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO

